

Drejtuar: Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë, Z. Edi Rama, dhe Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

Data: 24/09/2025

Subjekti: Deklaratë për Vendosjen e Rinisë Prioritet Strategjik në Qeverinë e Re

I nderuar Kryeministër, I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë,

Në vitin 2013 ne përshëndetëm përfshirjen e rinisë si fushë prioritare në veprimtarinë e qeverisë, në Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, më pas në Ministrinë e Arsimit, Rinisë dhe Sportit dhe më tutje krijimin e Ministrit të Shtetit për Rininë dhe Fëmijët në vitin 2021. Hapa që sollën përmirësimin e politikave që mbronin të drejtat e të rinjve dhe fëmijëve dhe promovonin pjesëmarrjen e tyre të drejtëpërdrejtë në shoqëri, duke e parë rininë si grup ndërsektorial në zhvillimin e të gjithë politikave.

Shpallja dhe miratimi i qeverisë së re, ka shqetësuar shumë aktorë rinorë dhe organizata pasi konstatojmë se nuk është parashikuar një portofol i dedikuar për rininë në asnjë prej ministrive. Ky fakt rrezikon që prioritetet rinore të fragmentohen duke humbur vazhdimësinë e politikave të ndërtuara gjatë viteve të fundit.

Të rinjtë në moshë 15–29 përbëjnë 21.3% të popullsisë së Shqipërisë. Ata përfaqësojnë një grup të rëndësishëm të fuqisë punëtore dhe potencial për një të ardhme të qëndrueshme të vendit, duke e bërë pjesëmarrjen e tyre vendimtare për zhvillimin ekonomik, social dhe politik të Shqipërisë. Sfidat e papunësisë (17.9%) dhe emigrimit (80% e të rinjve shprehin dëshirë për të emigruar) tregojnë se politikat rinore duhet të vazhdojnë të jenë të mirëkoordinuara si në nivelin qendror dhe atë vendor duke shënuar ndikime të matshme në jetën e të rinjve.

Nga një perspektivë e politikbërjes, është thelbësore të ruhet vazhdimësia dhe të mos ndërpritet puna që është bërë deri tani. Zbatimi dhe monitorimi i planeve ekzistuese për rininë, si Strategjia dhe Plan i Kombëtar për Rininë 2022–2029 dhe Garancia Rinore e mbështetur financiarisht nga BE, duhet të trajtohen me të njëjtin prioritet si hartimi i politikave të reja. Këto procese janë thelbësore për përmirësimin e kushteve të jetesës, lëvizshmërisë dhe qëndrimin e të rinjve në vendin tonë.

Për këto arsye, ne kërkojmë që:

1. Rinia të ketë një portofol të qartë dhe të dedikuar në qeveri;
2. Të ruhet gjithë puna e bërë deri tani dhe të ndërtohet mbi bazën e saj;
3. Rinia të mbetet prioritet i qartë strategjik i qeverisë së re.

Ne besojmë që ruajtja e fokusit të qartë mbi rininë do të kontribuojë në adresimin e sfidave të rëndësishme dhe që politikat rinore të jenë të koordinuara dhe të kontribuojnë në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Me respekt,

Lista e organizatave pjesëmarrëse:

1. Rrjeti i Profesionistëve të Rinj
2. UN Association Albania
3. Qendra për Studimin e Demokracisë dhe Qeverisjes
4. Hand to Hand Against Nation Apathy - H.A.N.A
5. Qendra për Edukim dhe Zhvillim CED
6. Qendra për Drejtësi Gjimore në Shqipëri
7. Qendra Mjedisore për Zhvillim Edukim dhe Rrjetëzim (EDEN)
8. Shoqata "Together for Life"
9. Youth Rights & Citizenship Initiative
10. United Rights Foundation
11. NECI Albania
12. Shoqata "Gender, Paqe e Siguri"
13. Agora Sociale
14. Qendra "Aleanca Gjimore për Zhvillim"
15. Envio
16. Qendra e Zhvillimit të Shoqërisë Civile, Durrës
17. Reinforce Sustainability
18. Akademia e Studimeve Politike / Academy of Political Studies
19. Qendra Shqiptare YMCA Albania
20. Qendra Shqiptare për Zhvillimin e Familjes
21. Qendra për të Drejtat në Punë CLR.AL
22. Komiteti Shqiptar i Helsinkit
23. Qendra EcoAlbania
24. Next Gen Advocates Albania
25. Rrjeti i Organizatave, Zëri i të Rinjve
26. Regional Center for Development and Cooperation
27. Aleanca kundër diskriminimit LGBT
28. European Movement Albania
29. Qendra për Progres Rinor
30. Shoqata Përtej Barrierave
31. Shoqata "Gruaja në Zhvillim Korçë"
32. Qendra Epoka e Re
33. Shoqata Qendra e Gruas "Hapa të Lehtë"
34. Institute of Human Rights and Non-formal Education
35. Co-PLAN Institute for Habitat Development
36. Këshilli Kombëtar Rinor
37. Shoqata Alpin
38. Instituti i Kultures Rome në Shqipëri - IRCA

39. Shoqata "Sebastia"
40. Shoqata GVV Kolonja e Gjelbër
41. Rrjeti i Fuqizimit të Gruas në Shqipëri
42. Qëndresa Qytetare
43. Fondacioni Shtegu i Shpresës
44. PPNEA
45. Rrjeti i Informimit dhe Qytetarisë Aktive
46. Federata Shqiptare e Sportit Shkollor
47. New Bridges
48. MDG Berat
49. Active Mobility Albania
50. Albania Community Assist
51. Organizata "Life Of Giving"
52. Qendra Shqiptare për Popullsinë dhe Zhvillimin, QSHPZH
53. The Door Center
54. Peace Volunteering Network/ PVN
55. Youth for Social Changes
56. Fondacioni Së Bashku
57. Shoqata "Sfinksi" e Minoritetit Egjiptian të Shqipërisë për Zhvillim dhe Integrim
58. Network Albania
59. Qendra "Strehëza Edlira Haxhiymeri" – SHE
60. ESD Albania
61. Drejtësi Sociale
62. Fondacioni Down Syndrome Albania
63. Albanian Students Abroad Network (ASAN)
64. Progresi për të Gjithë
65. AKS (Art-Kulturë-Sport)
66. ACT for SOCIETY Center
67. Sindikata e Pavarur e Artit, Kulturës dhe Medias të Shqipërisë (SPAKMSH)
68. Shoqata "Qendra Sociale në Ndihmë të Njerezëve në Nevoje" Fushë-Arrëz (QSNNN)
69. Qendra Haste
70. Centre for Health, Art, Sport, Tourism and Education
71. Vizion OJF
72. AMAD
73. CEI-Civic Engagement Institute
74. Grupi i Aktivisteve Ruralë të Dibrës
75. Mary Ward Loreto Foundation
76. Qendra për Studime Krahësuese dhe Ndërkombëtare (QSKN/CCIS)
77. Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve
78. Center for Development of Transferable Skills

- 79. Qendra Rinore “Perspektiva”
- 80. Akademia e Integrimit European dhe Negociatave (AIEN)
- 81. Instituti per Zhvillim Strategjik
- 82. New Vision
- 83. Shoqata për Zhvillim Mediatik
- 84. Instituti për Demokraci, Media dhe Kulturë
- 85. Rrjeti Erasmus - ESN Tirana
- 86. Albania Career Development Association
- 87. Qendra HASTE
- 88. Power of Education
- 89. Qendra DUA